



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Himarë, më 05 .06 . 2024

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 03.06.2024 ardhur me postë elektronike (e-mail) , ku kërkohet “Kërkesë për informacion” pranë Bashkisë Himarë. Për sa më sipër po ju përgjigjemi pyetjeve sipas renditjes së bërë në kërkesën tuaj:

1. Sezoni i plazhit ka filluar, por hyrja në Himarë ishte e vështirë për shkak të punimeve që po kryhen në qytet. Çfarë projektesh po realizohen?

Projektet që po realizohen janë si me poshte

“Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotur, sistemi i kanalizimeve, stacionet e pompimit, daljet në det Himarë dhe Orikum”

“Sistemi i furnizimit me ujë të Himarës, lidhja e linjës kryesore të dërgimit me sistemin e furnizimit me ujë të fshatrave Pilur, Kudhës, Himarë fshat, dhe Vuno si dhe rrjeti i brendshëm i ujësjellësit të këtyre fshatrave”.

Për të përshpejtuar rehabilitimin e akseve kryesore infrastrukturore, planifikohen punime rrugore

Fondi shqiptar i zhvillimit është financues dhe aplikues

Bashkia Himare perfituese.

2. Përse zhvillohen këto projekte në këtë kohë kur vështirëson akomodimin e turistëve nëpër hotele?

Jane pune dhe procese te filluara me shume se nje vit me pare. Ne kuader te sezonit turistik bashkia ne komunikim me investitorin dhe zbatuesin, kane gjetur menyren me te mire te mundshme per te pershpejtuar mbylljen e punimeve ne pikat e fluksit. Dhe momentalisht mbi 85% e rrugeve jane te kryera.

3. Cilat janë problematikat e identifikuara nga ju në këtë sezon turistik?

Përgjithësisht sezoni turistik 2024 në Himarë po fillon i qetë dhe jo me ndonjë problematikë të dukshme.

Në Himarë problem i vetëm, të cilit I është dhënë tashme zgjidhje është rikonstruksioni i rrugëve kryesore dhe dytësore si pasojë e realizimit të projekteve të siperpermendura.

Fondi shqiptar i zhvillimit është financues dhe aplikues i dy projekteve :

4. Çfarë masash ka marrë Bashkia për të qënë mikëpritës me turistët vendas dhe të huaj?

Se pari janë marrë masa për sigurinë e plazheve:

- Vendosja e kufijeve për mjetet lundruese në mënyrë që të mos futen në zonat ku lahen turistët,
- Përcaktimi dhe vendosja e korridoreve hyrese për mjetet lundruese
- Ndarja e kufijeve për stacionet e plazhit si edhe zbatimi i rregullores për rojet bregdetare

Se dyti argetimi dhe kulinaria:

- Mbeshtetja e disa eventeve me karakter artistik, kulturor dhe sportive (këtu përmendim South Outdoor Festival, Kala Fest, Bejk e Bardhe në Pilur apo edhe evente që do realizohen si Koncerti Olen Cezari, Panairi i Produkteve Artizanale, Traditat Kulinare Shqiptare, Panairi i Librit apo Liga e Lojërave të Aviacionit aktivitetet të cilat i kemi mirëpritur dhe mbështetur me qëllim për të rritur vizitueshmërinë dhe vizibilitetin për Himarën tonë.

5. Sa turistë pritet të vijnë në Himarë? Si janë të dhënat krahasuar me një vit më parë?

Sipas parashikimeve që ne kemi bërë, ky vit pritet të ketë një rritje mesatarisht 30% deri në 40% edhe pse pritshmërit tona janë për më tepër, duke futur dhe si faktor hapjen e tunelit të Llogarase. Duke iu referuar vitit të kaluar, shifrat flasin për një rritje pozitive që prej muajit Prill. Gjatë këtij viti, muaji Prill pati një rritje të ndjeshme (duke patur parasysh që edhe koha ishte më e qëndrueshme dhe njerzit patën mundësinë të shijojnë diellin dhe detin). Muaji Maj pati një rënie të lehtë për shkak të motit jo fort të mirë por muaji Qershor tregon dukshëm se ky sezon do të jetë shumë pozitiv për turizmin në bashkinë tonë.

6. A janë respektuar hapësirat e përcaktuara në ligj për plazhet publike? Sa përqind zënë dhe në cilat zona janë përcaktuar?

Sikundër e përmendëm edhe më sipër, Bashkia Himare ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të bërë ndarjen e stacioneve të plazhit ku pjesë e tyre janë edhe përcaktimi i hapësirave publike. Sipas ligjit në fuqi, hapësirat publike zënë 30%. Thuajse të gjitha plazhet e Bashkisë Himare kanë hapësirat e tyre të dedikuara për publikun e gjere. Në çdo plazh publik janë vendosur sinjalistika e nevojshme dhe monitorohen rregullisht për të siguruar mbarevajtjen e sezonit.

Ju falënderojmë dhe ju presim në Himarën tonë të bukur dhe mikëpritëse, ju presim të shijoni plazhet, ushqimin, malet dhe kulturën Himariote.